

REPUBLICA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME  
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 5154/5 Prot.

Tiranë më, 01/10/2019

**Lënda :** Dërgim i Raportit Final të Auditimit

**Drejtuar :** Z. Flamur Mamaj  
PREFEKT I QARKUT

Vlorë

**I nderuar Z.Mamaj,**

Bashkëlidhur dërgojmë Raportin Final të Auditimit, mbi auditimin e veprimtarisë në Institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë, për periudhën 01.04.2018 deri më 30.06.2019, të kryer në zbatim të planit vjetor të punës të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2019, të miratuar me shkresën prot.Nr.501, datë 22.10.2018.

Në zbatim të pikës d, të nenit 12 “Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike” të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikave: 4.1.12 “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar”, 4.1.13 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit” të MAB në Sektorin Publik të miratuar me Urdhrin e MF nr.100, datë 25.10.2016, nga ana Juaj të hartohet dhe të miratohet plani i veprimit me persona e afate konkrete për zbatimin e rekomandimeve dhe të dërgohet zyrtarisht në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, në MB, jo më vonë se **20 ditë kalendarike** nga marrja e Raportit Final të Auditimit.

Lutemi të respektoni afatet e dërgimit të planit të veprimit, për të vijuar nga ana jonë me informacionin për Ministrin dhe mbylljen e dosjes së auditimit sipas kërkesave të ligjit dhe manualit të auditimit.

Mbështetur në pikën 4.1.13.3 “Përgjegjësia e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB”, duhet të caktoni një punonjës që të evidentojë të gjitha rekomandimet e bëra nga auditimi i brendshëm dhe të komunikojë, monitorojë dhe informojë vazhdimisht DAB në MB për progresin që është bërë për zbatimin e tyre. Së bashku me Planin e Veprimit, lutemi të dërgoni personin e caktuar dhe pikat e kontaktit të tij.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin,

DREJTOR I AUDITIMIT

Arjan SULAJ



**RAPORT FINAL**  
**MBI**  
**AUDITIMIN E KOMBINUAR (PËRPUTHSHMËRIE DHE FINANCIAR) TË**  
**VEPRIMTARISË NË INSTITUCIONIN E PREFEKTIT TË QARKUT VLORË**

**I.Përmbledhje ekzekutive**

Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë është një Institucion qendror në nivel vendor i cili funksionon në zbatim të Ligjit nr.107/2016, “Për prefektin e qarkut” dhe akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e administratës shtetërore dhe nëpunësve civil.

*Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi i veprimtarisë të kësaj organizate sipas tematikave të miratuara në programin e auditimit për periudhën 01.04.2018 deri më 30.06.2019 rezultuan gjetjet si më poshtë:*

*-Në auditimin për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme rezultoi se,*

Në auditimin e fundit janë lënë për ndjekje e zbatim 32 rekomandime (përfshirë edhe 7 rekomandime të pazbatuara më parë). Nga ana e institucionit në planin e veprimit të hartuar për zbatimin e rekomandimeve nuk ka përfshirë 7 rekomandimet e mëparshme të pa zbatuara për periudhën deri më 31.12.2016 (sipas përcaktimit në rekomandimin nr.1 të Raportit Final).

-Plani i veprimit nuk është nënshkruar nga struktura menaxhuese e institucionit (përgjegjëse për hartimin e tij) dhe nuk është miratuar nga titullari i institucionit (Prefekti).

-Nuk është përcaktuar një punonjës për të monitoruar dhe raportuar në DAB të MB mbi progresin e bërë për zbatimin e rekomandimeve sipas afateve të përcaktuara në planin e veprimit.

-Nga 32 rekomandime gjithsej për ndjekje e zbatim, institucioni ka realizuar 10 rekomandime, ka realizuar pjesërisht (ose që janë në proces zbatimi) 5 rekomandime dhe nuk ka zbatuar 17 rekomandime nga të cilat 7 janë rekomandime të mbartura.

*Veprime në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe me pikën 4.1.13 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit” të MAB në sektorin publik të miratuar me UMF nr.100, datë 25.10.2016, përgjegjësi e strukturës së ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve dhe e titullarve të institucionit.*

*(Analitikisht gjetjet janë trajtuar në pjesën IV/1 “Gjetje e konkluzione” faqe 8).*

*-Në auditimin për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe përgjegjësi që rrjedhin nga ligji nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut” dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë objektin e veprimtarisë së këtij institucioni rezultoi se:*

- Mungojnë procedurat e shkruara në Rregulloren e brendshme, në rubrikën “Standardit të sjelljes së punonjësve të Institucionit të Prefektit” lidhur me; integritetin dhe objektivitetin, (kërkesat e nenit 20 të ligjit nr.10296, datë 08.7.2010).

Përshkrimet e punës së punonjësve janë të plotësuara për pozicionet e punë sipas strukturës së miratuar por këto përshkrime nuk janë të azhornuara duke marrë në konsideratë ndryshimet ligjore.

- Në lidhje me ekzistencën e procedurave për raportimin e gabimeve, mashtrimit dhe parregullsive, rezultoi se, institucioni nuk ka procedura të shkruara.

- Institucioni i Prefektit kishte Rregulloren e brendshme të funksionimit me detyrat funksionale të administratës sipas stukturës organizative aktuale, por kjo rregullore nuk jepte sigurinë për zbatimin të rregullave për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm si detyrim ligjor, përcaktuar në ligjin nr.10296, datë 26.06.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015, nenet: 5; 8; 9; 11; 12.

- Institucioni i Prefektit Vlorë nuk ka identifikuar dhe hartuar një strategji për menaxhimin e riskut si dhe nuk ka regjistër risku për të gjithë sektorët. Kjo mangësi ka sjellë mungesën e vlerësimit si duhet dhe raportimit të riskut, për rrjedhojë dhe të aktiviteteve të kontrollit për minimizimin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave të Sektorëve/Zyrave, veprim në kundërshtim me nenin 8, pika “a”, nenin 9,

11 dhe 21, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar dhe manualin e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

- Mungon manuali i proceseve të punës për çdo strukturë sipas ndarjes përkatëse dhe detajet që përcaktojnë rolin dhe detyrat brenda njësisë publike sipas formatit "Aneksit nr.2", bashkëlidhur manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit miratuar me urdhrin e MF nr.108, datë 17.11.2016 "Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit", trajtuar edhe më parë.

- Analiza vjetore e veprimtarisë së Institucionit të Prefektit për vitin 2018 është kryer duke evidentuar arritjet por nuk janë analizuar realizimi i objektivave, pengesat e hasura dhe aktiviteti i kontrollit për minimizimin e pengesave në realizimin e objektivave.

Megjithëse janë dhënë statistika përgjithsuese sipas veprimtarisë të institucioneve në rang qarku, mungojnë të dhënat mbi institucionet të cilat nuk kanë raportuar duke riskuar saktësinë e informacionit përgjithësues.

*Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me komponentët e kontrollit të ligjit të MFK dhe MKB, me impakt në mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit, përgjegjësi e kordinatorit të riskut (nëpunësit autorizues, pasi nuk kishte delegim të këtij funksioni).*

*-Në auditimin e shqyrtimit të lejeve të drejtimit të lëshuara jashtë RSH, trajtimi dhe vendimet e marra lidhur me trajtimin e tyre, rezultoi se:*

- Mungon ruajtja e numrit progresiv që identifikon dhe individualizon çdo vendim të marrë për periudhën Janar-Maj 2018. Në muajin Qershor është filluar me marrjen e vendimeve sipas numrave progresiv por mungojnë vendimet nr.7,8, 9 (Korrik 2018). U konstatua gjithashtu mungesë dokumentacioni të qartë mbi të cilat është marrë vendimi. Nga 65 vendime të marra gjatë vitit 2018 dhe 27 vendime për 6-mujorin e vitit 2019, në 24 raste procesverbali apo dokumentacioni mbështetës i procesverbalit (*testi me drags, raportit i shërbimit*) nuk janë të qarta dhe nuk lexohen. Nuk është kryer inventarizimi i dokumentacionit të dosjeve të trajtimit të lejeve të drejtimit nga Prefekti, dokumentacioni mbahej në dosje pa listë dokumentesh, pa fletën e inventarit standard-tip e cila të përfshijë emërtimin e dokumentacionit përbërës me numër progresiv fletësh, mbylljen e dosjes, dorëzuesin dhe marrësin në dorëzim në arkiv, në mosplotësim të kërkesave të germës "dh" nenet 9,36,40,64 të ligjit nr.9154, datë 06.01.1993, akteve nënligjore përkatëse dhe udhëzimin e Ministrit nr.388, datë 02.11.2010.

-Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, ka përcjellë për kompetencë në Institucionin e Prefektit Vlorë procesverbalet e konstatimit, dokumentet shoqëruese për shkeljen dhe lejen e drejtimit të mjetit të shtetasve, me vonesë nga 1 deri në 12 ditë, gjithësej në 58 raste nga të cilat 40 raste në vitin 2018 dhe 18 raste në 6-mujorin e parë të vitit 2019, me impakt negativ në imazhin e krijuar nga shtetasit e huaj dhe efekte të tjera negative. *Veprim në kundërshtim me pikën 9 të udhëzimit të MPB nr.687, datë 5.12.2013 "Për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese, administrimi i gjobave dhe pasqyrat statistikore në fushën e qarkullimit rrugor" i ndryshuar. Përgjegjësi e strukturave policore të hartimit të procesverbaleve, raportit të shërbimit dhe përcjelljes së tyre pranë Prefektit.*

- Institucioni i Prefektit ka shqyrtuar sanksionin plotësues të procesverbaleve të konstatimit të shkeljes të hyra në Institucionin e Prefektit dhe ka dalë me vendimin përkatës me 1- 8 ditë vonesë gjithësej në 22 raste nga të cilat 11 raste në vitin 2018 dhe 11 raste në 6-mujorin e parë të vitit 2019, me impakt negativ në imazhin e krijuar nga shtetasit e huaj dhe efekte të tjera negative. Sipas të dhënave (korespondencës), vonesat kanë ardhur për shkak të paqartësisë së dokumentacionit të ardhur nga Drejtoria Vendore e Policisë. *Veprim në shkelje të afatit prej 5 ditëve të parashikuar në pikën 9 të udhëzimit të MPB nr.687 datë 5.12.2013 "Për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese, administrimi i gjobave dhe pasqyrat statistikore në fushën e qarkullimit rrugor" i ndryshuar. Përgjegjësi e Sektorit Juridik dhe nëpunësit autorizues.*

*-Në auditimin lidhur me detyrimin e Institucionit të Prefektit për legalizimin e dokumenteve, rezultoi se:* Legalizimi i certifikatave të lëshuara nga organet vendore kryhet në Institucionin e Prefektit të Qarkut nëpërmjet Postës bazuar në marrëveshje të nënshkruar me dy filialet e Postës Shqiptare Sarandë dhe Vlorë

(nr.296 datë 20.02.2019 dhe nr.573 datë 15.04.2019) për të shmangur rradhët në Institucion dhe për t'i shërbyer aty ku ndodhet qytetari. Sipas nenit 3 të këtyre marrëveshjeve një vjeçare, procedura administrative e legalizimit të dokumenteve të lëshuara në RSH kryhet me pagesë të tarifës së shërbimit postar 100 lekë/dokumenti, pa lënë mundësi që shërbimi të merret falas direkt në Institucionin e Prefektit. Lidhja e marrëveshjes nga Institucioni i Prefektit, është kryer pa marrë në konsideratë pamundësinë e shtetasve për të paguar. Përveç pagesës së tarifave postare, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje, neni 2, pika 6, shërbimi i legalizimit të dokumenteve zgjatë 2 ditë (pika 6. "Afati i kthimit të dokumenteve të vërtetuara në Prefekturë është 48 orë nga momenti i pranimit"), ndërkohë që sipas pikës 4 të po këtij neni, Prefektura dorëzon brenda ditës dokumentet e legalizuara "Prefektura dorëzon çdo ditë në orën 13:00 dhe 15:30 dokumentet e legalizuara të marra në dorëzim në orën 10:00 dhe 13:00".  
*Veprim në kundërshtim me nenin 17 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative i republikës së shqipërisë", pikat 1; 2; dhe 3.*

*-Në auditimin mbi veprimtarinë e Sektorit të Zhvillimit Urban rezultoi se, komisioni prej tre anëtarësh ndër të cilët edhe përfaqësuesi i Institucionit të Prefektit, kanë kryer verifikimin e dokumentacionit dhe të sipërfaqes së truallit e përcaktuar për shitje duke dokumentuar procesin me procesverbal dhe duke nënshkruan genplanin por procesverbal nuk jep të dhëna nëpërmjet të cilave të garantohet se trualli shtesë funksional që kërkohet të privatizohet është pasuri shtetërore dhe i patransferuar në inventarin e njërive të qeverisjes vendore, në bazë të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore që i përket sipërfaqes së truallit shtesë". Gjithashtu procesverbal nuk jep të dhëna nëse është zbatuar limiti i sasisë së sipërfaqes shtesë që mund të përftojnë subjektet për objekte të veçuara të privatizuara dhe për ndërtesat e ndërtuara mbi bazën e lejeve të ndërtimit. Përfaqësuesi i Institucionit të Prefektit, nuk mbante në dosje gjithë praktikën (mungonte genplani në një rast). Veprime në kundërshtim me VKM-së nr.413 datë 25.06.2014 "Për përcaktimin e kritereve e të procedurave të shitjes së trojeve në përdorim, sipërfaqe të domosdoshme, dhe trojeve shtesë funksionale të ndërmarrjeve shoqërive tregtare, të objekteve shtetërore të veçuara, të privatizuara, të objekteve apo ndërtesave të shitura të ish-kooperativave bujqësore, si dhe të ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit" i ndryshuar, kreu II, pika 5. Përgjegjësi e komisionit, pjesë e të cilit ishte dhe z.E.A (nga Institucioni Prefektit).*

*(Analitikisht gjetjet janë trajtuar në pjesën IV/2 "Gjetje e konkluzione" faqe 14).*

*-Në auditimin për verifikimin e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore rezultoi se:*

Sa i përket emërimit të personelit të KVVTP sipas profesioneve të miratuara në lidhjen nr.1 të VKM nr.1269, datë 17.09.2008 rezulton se, deri më 30.06.2019 në profesionin "Agronom apo inxhinierë gjeodetë ose teknikë topograf i licensuar", është emëruar një specialist me profesionin (Ing.Ndërtimi). Konstatim ky edhe në auditimet e mëparshme, me ndikim në realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë të KVVTP-së sa i përket vlerësimit në afat të kërkesave dhe vlerësimit agronomik të dokumentacionit mbi tokën bujqësore, në mospërputhje me kapitullin III, paragrafi A pika 1 lidhja nr.1 të VKM nr.1269, datë 17.09.2008, i ndryshuar me vendimin nr.144, datë 23.02.2011, përgjegjësi e Prefektit të Qarkut.

KVVTP, për periudhën objekt auditimi (viti 2018 deri më 30.06.2019) nuk ka përmbushur dhe realizuar objektivin kryesor të veprimtarisë së vetë "Shqyrtimin në afat të kërkesave për vlefshmërinë e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", si dhe nuk ka marrë masat e duhura procedurale dhe dokumentare për përfundimin e shqyrtimit të kërkesave brenda afteve ligjore të miratuara (deri më 30.06.2019 nga 205 kërkesa të hyra gjithsej janë në proces me tejkallim të afateve të përfundimit të shqyrtimit 131 kërkesa ose pa përfunduar 64% të kërkesave të cilat në krahasim me fundvitin 2017 janë në rritje). Kjo situatë është rezultat i,

-Mos vlerësimit si duhet të objektit të kërkesave që në momentin e paraqitjes së kërkesës (objekte të ligjit nr.9948 datë 07.07.2008) dhe dokumentacionit justifikues të kërkes-ankesës, natyrës, kompetencës, afateve dhe formës së paraqitjes së sajë, siç kërkohet në Kapitullin XI nenet 90 - 95, nenin 44, pika 2, gërma b, të Ligjit nr.44/2015, "Kodi i Procedurës administrative".

-Kalimit me vonesë të kërkesës për veprim specialistëve të KV-së nga ana e Drejtorit të KV-së (*kërkesat sipas kartelës shoqëruese të protokollit janë kaluar për veprim me 2-9 ditë vonesë*), si dhe mos dokumentimit dhe miratimit të shtyrjes së afatit të përfundimit të shqyrtimit të kërkesave nëpërmjet një relacioni me arsyet e shtyrjes së afatit, siç kërkohet në kreun II nenet 8, 9, 10 dhe 12 të VKQT nr.1, datë 27.03.2009 "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e KV".

-Mos përcaktimit në shkresat drejtuar institucioneve shtetërore të dokumentacionit të plotë që duhet të paraqitet për shqyrtimin e objektit të kërkesës, siç përcaktohet në nenet 3,4,7,8,9 të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008, si dhe në kërkesat e Udhëzimit nr.2, datë 13.01.2010.

-Moskryerjes së analizës mbi arsyeve e mos përfundimit të shqyrtimit të kërkesave brenda afatit 90 ditor nga data e hyrjes së kërkesës në institucion si dhe mos informimit të titullarit (Prefektit) mbi problemet e krijuara nga institucionet shtetërore dhe masave administrative të propozuara ndaj institucioneve që kanë penguar veprimtarinë e KVVTP-së, siç përcaktohet në nenin 13 të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008.

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me, nenin 7 pika 2, nenet 8, 9 dhe 13 të ligjit nr.9948 datë 07.07.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" i ndryshuar, me pikën 1 të nenit 49 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" dhe me kërkesat e Vendimit të KQT nr.1, datë 27.03.2009 "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e KV", veprime të cilat, bazuar në kreun III, gërma A, pika 5 e VKM nr.1269, datë 17.09.2008 "Për përbërjen, funksionimin detyrat dhe përgjegjësitë e KVVTP", përgjegjësi e Drejtorit të KVVTP-së.

Sa i përket detyrimit ligjor që KVVTP ka për të bërë kallzim penal në organet e drejtësisë ndaj personave fizikë ose juridikë për shpërdorim të detyrës dhe shpërdorim të tokës evidentojmë se, nga ana e KVVTP Vlorë për vitin 2018 e në vijim nuk është bërë asnjë kallzim penal edhe pse gjatë kësaj periudhe kanë marrë formë të prerë të gjykimit 4 vendime pavlefshmërie, në moszbatim të pikës 1 të nenit 15 të Ligjit nr.9948, datë 07.07.2008, të ndryshuar, përgjegjësi e Drejtorit të KVVTP.

Për vitin 2018 deri më 30.06.2019 nga ana e KVVTP-së Vlorë, programi i planifikuar e i miratuar për kontrollin e drejtpërdrejtë të vlefshmërisë së AMTP-ve për njësitë administrative Bashkia Vlorë dhe Himarë (*program në vijim të programeve të mëparshme të pa realizuara*) nuk është realizuar. Veprim në kundërshtim me kreun II nenin 7 pika b, të ligjit nr.9948/2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore për krijimin e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" i ndryshuar dhe me pikat 2,3 dhe 4 të UKM nr.1, datë 13.01.2010 "Për mënyrën e verifikimit dhe shqyrtimit të titujve të pronësisë mbi tokën në ish NB dhe zonat me përparësi turizmi", përgjegjësi e strukturës së KVVTP.  
(*Analitikisht gjetjet janë trajtuar në pjesën IV/3 "Gjetje e konkluzione" faqe 23*).

-Në auditimin e verifikimit dhe konfirmimit të ligjshmërisë së akteve me karakter normative rezultoi se:

-Struktura përgjegjëse, Sektori Juridik nuk ka kryer ndarje detyrash midis punonjësve në këtë proces, për rrjedhojë mungon dhe adresimi i përgjegjësive dhe hierarkia e raportimit. Janë konfirmuar nga Prefekti (në disa raste janë kthyer) aktet normative që i përkasin fushave të ndryshme pa marrë mendimin e dokumentuar të sektorëve të tjerë me specialistë të fushës. Mungon relacioni sqarues nga struktura që ka kryer kontrollin mbi bazueshmërinë ligjore. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 4, pika 3, neni 8, pika 5, neni 11. Në kundërshtim dhe me Urdhërin e Prefektit nr.24, datë 16.04.2014. Duke ngarkuar me përgjegjësi këtë sektor.

-Aktetet normative të ardhura nga këshillat e njësisve vendore për konfirmim, nuk japin të dhënat e duhura për një kontroll më të shpejtë dhe të saktë nga ana e Institucionit të Prefektit, pasi mungojnë të dhëna të domosdoshme si pjesëmarrja e domosdoshme e këshilltarëve, hyrja në fuqi e aktit, të dhëna sintetike dhe analitike të rakorduara, relacioni sqarues etj.

(*Analitikisht gjetjet janë trajtuar në pjesën IV/4 "Gjetje e konkluzione" faqe 32*).

-Në auditimin e sistemit të të ardhurave të realizuara rezultoi se:

Institucioni i Prefektit Vlorë realizon 8,624 lekë/muaj të ardhura nga dhënia me qira e një ambienti (ish-zyra e kontrollit teknik me sipërfaqe 43,12 m<sup>2</sup> me çmim 200 lekë/m<sup>2</sup>). Sa i përket procedurës ligjore të dhënies me qira të objektit konstatojmë se, kontrata e lidhur për dhënie objekti me qira subjektit privat nuk është ligjore pasi Institucioni i Prefektit nuk e ka në pronësi objektin (nuk e ka regjistruar në ZVRPP) dhe nuk administron dokumentacionin përkatës të objektit. Edhe pse ky konstatim është evidentuar edhe në auditimet e mëparshme, institucioni nuk ka marrë masat për dokumentimin, regjistrimin në ZVRPP për kalimin e pronësisë së objektit, në kundërshtim me *Kreun II "Procedurat e dhënies me qira ose emfiteozë të pasurisë shtetërore"* të VKM nr.54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurës e të mënyrës së dhënjes me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, përgjegjësi e nëpunësit autorizues dhe zbatues të institucionit.

-Sa i përket dokumentimit dhe rakordimit të certifikatave të GjC të marra nga MB pa pagesë rezulton se, institucioni nuk ka kryer inventarizimin, rakordimin dhe dokumentimin e certifikatave që kanë në administrim ZGJ Civile. Institucioni nuk ka rregulla të qarta për dokumentimin e përdorimit të certifikatave nga Zyrat e GJC, si dhe nga sektori i financës dhe punonjësit e ZGJC nuk kryhet vlerësimi i certifikatave të dala jashtë përdorimit, rakordimi dhe inventarizimi i certifikatave gjendje, në mospërputhje me pikën 80 të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", përgjegjësi e nëpunësit zbatues të institucionit.  
(Analitikisht gjetjet janë trajtuar në pjesën IV/5 "Gjetje e konkluzione" faqe 34).

-Në auditimin e dokumentacionit të likujdimeve nëpërmjet bankës dhe procedurave të prokurimit, rezultoi se:

Në të gjitha rastet, urdhër shpenzimet e likujdimit të fondeve për procedurat e blerjes së mallrave dhe shërbimeve nuk kanë të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues (fletë-hyrja e mallit si dhe proces verbali i marrjes në dorzim të mallit apo shërbimit) ky dokumentacion administrohet më vete në sektorin e financës, në mospërputhje me gërmën "f" pika 4 e nenit 9, gërmën "e" pika 3 e nenit 12 dhe me nenin 22 të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" si dhe në pikën 36 dhe 54 të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", përgjegjësi e nëpunësit zbatues të institucionit.

Institucioni i Prefektit, ka të regjistruar në llogari detyrime për tre vendime të formës së prerë të gjykatës vlerën 276,250 lekë (166,840 lekë shpenzime gjyqësore dhe 127,400 lekë tarifa përmbartimore) për t'i likujduar gjatë vitit 2019. Për këto vendime, institucioni i Prefektit nuk ka të dokumentuar përfaqësimin në gjykatë për mbrojtjen e kërkesë padive. Zyra juridike dhe sektori i financës nuk administrojnë të gjithë praktikën shkresore të procedurës së ndjekur, nuk kanë hartuar dhe dokumentuar gjurmën e auditit për nxjerrja e përgjegjësive administrative, si dhe nuk kanë marrë masat për likujdimit e shpenzimeve gjyqësore në mënyrë vullnetare, me pasojë kjo në shtimin e panevojshëm për të likujduar me fonde buxhetore të akorduara për vitin 2019 vlerën 127,400 lekë "Shpenzime dhe tarifa përmbartimore", në mospërputhje me pikën II.2/62 të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", VKM nr.335, datë 02.06.1998 "Për procedurat e zbatimit të vendimeve gjyqësore për detyrime që prekin buxhetin e shtetit" si dhe Udhëzimin e KM nr.1, datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve nga institucionet shtetërore në llogari të thesarit", përgjegjësi e nëpunësit zbatues dhe zyrës juridike të institucionit.

Në një rast konstatojmë se, fondi 3,000,000 lekë i akorduar shtesë nga MB gjatë vitit 2018 për "Blerje të 1 automjeti", nuk është përfshirë në regjistrin shtesë të parashikimit të prokurimeve, si dhe nuk është njoftuar APP-në për të bërë ndryshimet në regjistrat përkatës të publikuara në faqen elektronike të APP-së, siç përcaktohet në nenin 4 pika 4 dhe nenin 7 pika 1 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të PP" i ndryshuar, përgjegjësi e sektorit të financës/shërbimeve mbështetëse dhe sektorit juridik të institucionit.

(Analitikisht gjetjet janë trajtuar në pjesën IV/7 "Gjetje e konkluzione" faqe 38).

-Në auditimin e trajtimit të punonjësve me paga, shitesa mbi pagë, rezultoi se:

-Tre punonjës të Institucionit të Prefektit, vazhdonin të ishin në marrëdhënje punë edhe pse kishin plotësuar moshën për pension të plotë pleqërie, në kundërshtim me VKM nr.478, datë 16.06.2010, "Për ndërprerjen e marrëdhënjëve të punës, nga organet e administratës shtetërore, pas plotësimit të kushteve për pension pleqërie", përgjegjësi e nëpunësit autorizues.

-Nga tre raste largimi nga puna të tre ish-punonjësve për periudhën objekt auditimi, dy prej tyre (N/Prefekti Sarandës dhe specialisti i KVTP-së) nuk është bërë dorëzimi i detyrës me procesverbal për dokumentacionin shkresor, elektronik, e gjithçka e krijuar gjatë punës në institucion, me impakt negativ në vazhdimësinë e punës, në kundërshtim me kërkesat ligjore si më poshtë: Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", VKM nr.360, datë 14.07.2000 "Për lirin nga shërbimi civil", pikat 19, 20 dhe 21 "Dorëzimi i detyrës", VKM nr.171, datë 26.03.2014 "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", pika 5, ligjin nr.7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i RSH" i ndryshuar, nenin 25 "Detyrimi i dhënies llogari dhe i kthimit" pika 3. Përgjegjësi e nëpunësve autorizues dhe zbatues.  
(Analitikisht gjetjet janë trajtuar në pjesën IV/8 "Gjetje e konkluzione" faqe 43).

-Në auditimin e mbajtjes së kontabilitetit dhe inventarizimit rezultoi se.

Për shkak të moszbatimit të rekomandimeve të mëparshme, vazhdojnë të njëjtat gjetje të konstatuara dhe më parë e konkretisht,

- Inventarizimi i objekteve ndërtimore nuk është bërë për sipërfaqe por vetëm me objekte ndërtimore në copë pa përshkrimin e brendshëm të ndërtesës. Gjithashtu edhe për mjetet e transportit nuk ishte kryer inventarizimi sipas inventarit të brendshëm të automjeteve por me copë, veprim në kundërshtim me pikën 76 të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011, përgjegjësi e komisionit të inventarizimit.

-Institucioni i Prefektit Vlorë, nuk mbante evidencën kontabile dhe nuk kishte regjistruar në ZVRPP objektet ndërtimore sipas të dhënave të VKM nr.1691, datë 10.10.2007 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë..." i ndryshuar, veprim në kundërshtim me ligjin nr.33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me pikën 26, kreu III-të Regjistri i aktiveve të njërive të sektorit publik të UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

-Për objektet ndërtimore nuk është përcaktuar vlera e tokës dhe truallit të objekteve ndërtimore në kundërshtim me vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH". Vlera e truallit nuk është pasqyruar në bilancin vjetor 2018, në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe pikën 26, kreu III-të Regjistri i aktiveve të njërive të sektorit publik të UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", përgjegjësi e nëpunësve autorizues e zbatues sipas periudhave.

(Analitikisht gjetjet janë trajtuar në pjesën IV/9 "Gjetje e konkluzione" faqe 46).

Konkluzion: Nga auditimi i ushtruar në Institucionin e Prefektit Vlorë, grupi i auditimit konstaton se, Institucioni i Prefektit, ndonëse është përpjekur për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fushat përkatëse, ka vend për identifikimin e kontrolleve të munguara, forcimin e kontrolleve ekzistuese, vlerësimin e riskut e trajtimin e tij, kjo referuar gjetjeve të konstatuara e të trajtuara në këtë material Auditimi.

Në vijim të këtij materiali, në pjesën IV "Gjetje e konkluzione" në mënyrë të detajuar gjetjet e mësipërme janë të analizuara mbi bazën e kërkesave ligjore dhe kanë të përcaktuar edhe përgjegjësinë menaxheriale të strukturës.